



Republika e Kosovës

Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit

Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor

Nr : 04-353/01-12243

Data: 03.09.2024

Prizren

**DREJTORIA PËR URBANIZËM DHE PLANIFIKIM HAPËSIROR KK – PRIZREN,** me kërkesën e **Fat Group Sh.P.K. Prizren,** me të cilën pala ka kërkuar leje për: **zhvendosjen e rrjetit 0.4kV,** e në bazë të e në bazë të nenit 3 paragrafit 1,pika 1.27 te Ligjit per Planifikimit Hapsinor me Nr.04/L-174 te Dt.31.07.2013,nenit 3.1.1,1.2,1.4,1.17,1.24, e në lidhje me nenin 4,1.2,si dhe nenit 5,1.1 si dhe nenin 14.1.2,të Ligjit për ndërtim nr. 04/L-110, dhe sipas Vendimit për miratimin HZK per peridhen 2022-2030 Nr.001-011-48192 te dt 31.03.2022, dhe të nenit 85 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 27,44,46,47,48 të L.P.P.A nr.05/L-031 dt. 25.05.2016 merr këtë:

## AKTVENDIM

**I LEJOHET - : Fat Group Sh.P.K. Prizren,** me të cilën pala ka kërkuar leje për: **zhvendosjen e rrjetit 0.4kV në rrugën e Mursel Osmanaj, pn. Prizren.**

- I. Të punohet simbas dokumentacionit të hartuar nga KEDS Sh.A. – Operatori I Sistemit të Shpërndarjes jep zgjidhjen teknike.
- II. Datën e fillimit të punimeve investitori është i obliguar që të lajmërojë inspektionin komunal në afat prej 8 ditësh.
- III. Hunjëzimi i objektit të bëhet simpas dokumentacioni teknik..
- IV. Investitori është i obliguar që punimet rreth infrastruktures të kryen sipas Aktvendimit të dhëna, kurse vend punimi natën të ndriqohet me dritë ashtu që të mundësohet qarkullimi i lirë i automjeteve dhe të këmbësorëve, kurse materialet të tjera duhet të menjanohen nga rruga ku janë kryer punimet.
- V. Ky aktvendim pushon të vlejë në rastë se me punë nuk fillohet mbrenda afatit prej 12(dymbdhjetë) muajsh,duke llogaritur nga dita e marjes së të njejtës
- VI. Pas kryerjes së punimeve Investitori është i obliguar që vendpunishten menjëherë të bjerë në gjendje të mëparshme.
- VII. Pas përfundimit të ndërtimit investitori duhet të parashtrojë kërkesën për pranimin teknik dhe marrjen e lejes për shfrytëzim.
- VIII. Ky aktvendim pushon të vlejë në rastë se me punë nuk fillohet mbrenda afatit prej 12 (dymbdhjetë) muajsh,duke llogaritur nga dita e marjes së të njejtës.

Kjo Leje Ndërtimore bazohet në shqyrtimin e provave:

- Njoftim për plotësimin e dokumentacionin 04-353/01-122436 dt. 15.03.2024.
- Zgjidhjen teknike nga "KEDS" Sh.A. te dates 26.12.2024.
- Pëlqimin nga DSHP për infrastrukturën nëntoksore të lokacionit te dates 22.08.2024.
- Pëlqimet të noterizuara nga pronarët e ng. kad. ku do të vendosen shtyllat.

P.S. Investitori është përgjegjës dhe obligohet që gjitha dëmtimet e mundshme të rrjetit të ujësjellësit,kanalizimit, PTK, KEDS-it,si dhe avari tjera ti evitoj dhe ti kthej në gjendje të mëparshme me shpenzimet të veta dhe pa të drejtë kompensimi.

## A r s y e t i m

**Fat Group Sh.P.K. Prizren**,është drejtuar këtij organi për marrjen e lejes për : **zhvendosjen e rrjetit 0.4kV në rrugën Mursel Osmanaj, pn Prizren.**

Duke shqyrtuar kërkesën e Investitorit si dhe dokumentacionit teknik dhe të shtojcave tjera të prezentuara s'bashku me kërkesë vërtetohet se:

Në procedurën paraprake është kontrolluar dokumentacioni teknik nga ana e bashkëpunëtorit profesional.

Në kuptim të dispozitave të lartë theksuara është konstatuar se janë plotësuar kushtet për dhënien e lejes për : zhvendosjen e shtyllës metalike të tensionit të lartë në rrugën e "Zahir Pajaziti".

Nga se u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtës MMPHI së-Prishtinë.

**Bashkëpunëtor profesional:**

**Shpresa Osmanollaj Krapci, inxh.dip.ark.**

**DREJTORI:**

**Pranverim Berisha,jur.**

